



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.9/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit V.A, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga I. H, nga J., me banim në lagjen “Q..”, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 11.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga I.H, nga ., ndaj gjyqtarit V.A, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 05.07.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konform nenit 9 par.1 pika 1.1 lidhur me par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë të Autoriteti Kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga I.H, nga J., me banim në lagjen “Q..” pn, ndaj gjyqtarit V.A, me arsyetimin se përveç sulmit fizik nga A.K, për të cilën është në zhvillim e sipër procedura tjetër gjyqësore tek gjyqtari B.A, ekziston edhe rasti i datës 17.05.2024, ku i njëjti është sulmuar dhe lënduar nga daja i A.K nga Juniku, Xh.Sh, lëndë në gjykim tek gjyqtari V.A. Deklaron se gjyqtari V.A në lëndën P.nr....., të datës ..., ka bërë padrejtësi duke shqyrtuar materiale jashtë kësaj lëndë gjyqësore dhe konsideron absurde se “kush po e urdhëron apo mban në grusht gjyqtarin A me e thy me dy duar ligjin dhe drejtësinë e Republikës së Kosovës”.

Me datë 08.07.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga I.H, ndaj gjyqtarit V.A.

Gjyqtari V.A, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit së ankesës ka deklaruar se pranë Gjykatës Themelore në Pejë është ngritur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë, me shenjën PP/II.nr....., të datës ..., ndaj të pandehurit Xh.Sh për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 186.1, nënpar.1.3, të KPRK-së, ku palë e dëmtuar është I.H. Gjykata me datën ..., në ora ... ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku i pandehuri nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale të akuzuar. Pretendimet e të dëmtuarit se janë bërë padrejtësi nga ana e gjyqtarit, janë të pabazuara, të paargumentuara, të dëmtuarit në seancën e shqyrtimit fillestar i janë respektuar të gjitha të drejtat procedurale të garantuara me Kodin e Procedurës

Penale dhe i njëjti pa ndonjë arsye nuk e ka nënshkruar procesverbalin e shqyrtimit fillestar. I njëjti ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të dëmtuarit.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit V.A, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është dukshëm joserioze dhe e pabazuar.

Autoriteti kompetent me vëmendje ka vlerësuar pretendimet e parashtruesit të ankesës dhe lidhur me pretendimet e tij se kinse gjyqtari ka bërë padrejtësi ndaj tij duke shqyrtuar materiale jashtë lëndës në të cilën i njëjti është pala e dëmtuar, ka gjetur se pretendimet e tilla të ankuesit janë të paargumentuara dhe të pa mbështetura në asnjë provë të vetme. I njëjti, po ashtu me asnjë provë nuk ka argumentuar se gjyqtari nuk është i pavarur dhe tjera të ngjashme andaj, deklaratimet e tilla si të vetme dhe të pa argumentuara me asnjë provë nga ana e parashtruesit të ankesës, nuk mund të merren për bazë për inicimin eventual të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.9/24, me datë 11.07.2024.

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit V.A*
- 3. Parashtruesit të ankesës – I.H, nga J*